



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Bashkim Ramosaj , Kryetar i Komunës së Deçanit Haki Shehaj , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Deçanit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević , Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Shkelqim Jakupi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Date: 03/08/2018 Nr.020-913
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Deçanit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktet komunale në vijim:

Vendim 01.Nr.VIII-5 për shpalljen e zonave me interes për komunën e Deçanit
I miratuar më datë: 27/07/2018
Të parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02/08/2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za:	Bashkim Ramosaj, gradonačelnik Opštine Dečan Haki Shehaj, predsedavajući Skupštine opštine Dečan	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko: ZA:	Ivan Todosijhević, ministar MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a,	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS - <i>[Signature]</i>	Datum, 02.08.2018. Br.020-913
Predmet:	Potvrda zakonitosti akata opštine Dečan	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Dečan	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01.br.VIII-5 za objavljivanje od opšteg interesa za opštinu Dečan
Usvojene dana, 27.07.2018. godine
Predložene za razmatranje u MALS-u dana 2.08.2018. godine

Ministartstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat.

Ministartstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
Ministry of Local Government Administration
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Lokalne Samouprave / Administration
Directorate of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 02.08.2018
Kategoria / Kategorija / Category: Nr. Llogaritja / Broj / No: -VI-060-313



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA / REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT / MUNICIPALITY OF DEÇAN / OPŠTINA DEÇANI

Në mbështetje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 12 të Ligjit për dhenien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr 04/L-144, dhe në bazë të nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur më dt.27.07.2018, bie këtu:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E ZONAVE ME INTERES PËR KOMUNËN E DEÇANIT

I.

SHPALLEN zona me interes me qëllim të përfitimit publik në Komunën e Deçanit ngastrat kadastrale siç janë të cekura në vijim:

- Ngastra nr.638-1 në sipërfaqe prej 29804 m² me kulturë kullosë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore P.SH.O.TH.P.B.KOSOVODERVO PRISHTIN O.P.GJERAVICA, vendi i quajtur SUKA, Zona Kadastrale Baballoq.
- Ngastra nr.638-2 në sipërfaqe prej 56080 m² me kulturë kullosë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore P.SH.O.TH.P.B.KOSOVODERVO PRISHTIN O.P.GJERAVICA, vendi i quajtur SUKA, Zona Kadastrale Baballoq.
- Ngastra nr.638-3 në sipërfaqe prej 109833 m² me kulturë kullosë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore P.SH.O.TH.P.B.KOSOVODERVO PRISHTIN O.P.GJERAVICA, vendi i quajtur SUKA, Zona Kadastrale Baballoq.
- Ngastra nr.638-4 në sipërfaqe prej 160578 m² me kulturë kullosë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore P.SH.O.TH.P.B.KOSOVODERVO PRISHTIN O.P.GJERAVICA, vendi i quajtur SUKA, Zona Kadastrale Baballoq.
- Ngastra nr.638-5 në sipërfaqe prej 89342 m² me kulturë kullosë e cila evidentohet si Pasuri shoqërore P.SH.O.TH.P.B.KOSOVODERVO PRISHTIN O.P.GJERAVICA, vendi i quajtur SUKA, Zona Kadastrale Baballoq.
- Ngastra nr. 945-0 në sipërfaqe prej 87 m², e cila evidentohet si Pasuri shoqërore NDERMARRJA NDERTIMORE E HIDROEKONOMIS-BISTRICA, Zona Kadastrale Deçan.

II.

Bazuar në Ligjin e ri Mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës me nr.04/L-144, neni 12. Komuna do t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës me kërkesë për kthimin e këtyre pronave në pronësi të Komunës me qëllim të realizimit të interesit publik.

III.

Procedurat për zbatimin e këtij vendimi do t'i udhëheq Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë – Shërbimi pronësoro juridik KK Deçan .

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës

V.

Shtojce e këtij Vendimi do të jetë arsyeshmeria në formë të shkruar, Çertifikatat e pronësisë dhe planet e fotokopjuara.

Me Vendim njoftohen Qeveria e Kosovës, MAPL, AKP, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.VIII-5

Deçan,dt.27.07.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i kuvendit:
Haki Shehaj

